



Република Северна Македонија

Агенција за супервизија на капитално финансирано пензиско осигурување



Republika e Maqedonisë së Veriut

Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional

PLANI FINANCIAR  
I AGJENCISË PËR MBIKËQYRJE TË  
FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT  
PENSIONAL PËR VITIN 2023

MAPAS

Agjencia për mbikëqyrje  
të financimit kapital të  
sigurimit pensional



## Përmbajtja

I. Hyrje .....	3
II. PLANI FINANCIAR.....	4
1. TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA.....	5
1.1 Kompensimi i kontributeve nga shoqëritë pensionale.....	5
1.2 Kompensimet administrative.....	5
1.3 Të ardhurat nga kamatat.....	5
2. SHPENZIMET E PLANIFIKUARA.....	6
2.1 Materialet e shpenzuara.....	6
2.2 Energjia e shpenzuar dhe shërbimet komunale.....	6
2.3 Mirëmbajtja investuese e mjeteve.....	7
2.4 Shërbimet e tjera.....	7
2.5 Shërbimet e transportit.....	9
2.6 Shpenzimet për reklama dhe reprezentacion.....	9
2.7 Qiratë.....	9
2.8 Shërbimet tjera materiale.....	10
2.9 Provizioni për qarkullimin pagesor.....	10
2.10 Premitë e sigurimit.....	10
2.11 Shpenzimet e rrugës dhe shpenzimet ditore.....	11
2.12 Taksat e anëtarësisë.....	11
2.13 Shërbimet intelektuale dhe shërbimet e tjera.....	11
2.14 Shpenzimet e tjera.....	12
2.15 Mjetet për objektet ndërtimore.....	12
2.16 Mjetet për pajisje.....	13
2.17 Mjetet tjera kapitale.....	13
2.18 Rrogat dhe kompensimet e llogaritura.....	14
2.19 Tatimet dhe kontributet që nuk varen nga rezultati.....	14
<b>Bashkëngjitja 1. Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional – Pasqyra analitike e të ardhurave dhe shpenzimeve.....</b>	<b>15</b>
<b>Bashkëngjitja 2. Rezultati i planifikuar financiar për vitin 2023.....</b>	<b>21</b>

## Plani Financiar për vitin 2023 i Agjencisë për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (MAPAS)

### I. Hyrje

Agjencia për Mbikëqyrje të Financimit Kapital të Sigurimit Pensional (në tekstin e mëtejshëm: Agjencioni) është trup rregullator i mëvetësishëm dhe i pavarur i themeluar në bazë të Ligjit për sigurimin e detyrueshëm pensional me finansim kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018, 245/2018, 180/2019 dhe 103/2021 (në tekstin e mëtejshëm: Ligji).

Në pajtim me nenin 46 të Ligjit, Agjencioni ka cilësinë e personit juridik me autorizime publike të përcaktuara me këtë ligj dhe me këtë statut. Organi drejtues dhe mbikëqyrës i Agjencionit është Këshilli i Ekspertëve, ndërsa për punën e vet përgjigjet përpara Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i themelimit të tij është mbrojtja e interesave të anëtarëve të fondeve pensionale dhe nxitja e zhvillimit të finansimit kapital të sigurimit pensional. Agjencioni është themeluar për kryerjen e mbikëqyrjes në punën e shoqërive për menaxhimin e fondeve të detyrueshme pensionale, shoqërive për menaxhimin e fondeve vullnetare pensionale dhe shoqërive për menaxhimin e fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale (në tekstin e mëtejshëm: shoqëritë pensionale) dhe mbikëqyrjes së fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale (në tekstin e mëtejshëm: fondet pensionale).

Në pajtim me nenin 47 të Ligjit, Agjencioni është kompetent:

- të lëshojë, tërheq dhe heq leje dhe miratime për themelimin e shoqërive pensionale për menaxhimin me fondet e detyrueshme dhe/ose vullnetare pensionale;
- të kryejë mbikëqyrjen e punës së shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale të cilat i menaxhojnë, si dhe kujdestarëve të mjeteve të fondeve pensionale dhe menaxherëve të huaj të mjeteve;
- të promovojë, organizojë dhe e nxit zhvillimin e finansimit kapital të sigurimit pensional në Republikën e Maqedonisë së Veriut, në bashkëpunim me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe ta rrit ndërgjegjësimin e opinionit për qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionale dhe fondeve pensionale;



- të miratojë akte në pajtim me Ligjin për sigurimin e detyrueshëm pensional me finansim kapital, Ligjin për sigurimin vullnetar pensional me finansim kapital dhe Ligjin për pagesën e pensioneve dhe kompensimeve të pensioneve në finansimin kapital të sigurimit pensional, si dhe udhëzime profesionale, doracakë dhe ngjashëm, në lidhje me finansimin kapital të sigurimit pensional dhe të iniciojë miratimin e rregullave dhe akteve tjera lidhur me shoqëritë pensionale dhe fondet pensionale të cilat i menaxhojnë.

Puna e Agjencionit në pajtim me nenin 56 paragrafi (3) të Ligjit financohet nga kompensimet të cilat Agjencioni i arkëton nga shoqëritë pensionale (kompensimi mujor nga çdo shoqëri pensionale dhe kompensimet administrative). Pëlqim për lartësinë e kompensimeve jep Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut në bazë të propozimit të përcaktuar nga Këshilli i Ekspertëve i Agjencionit.

Shuma e kompensimit mujor që e arkëton Agjencioni, nga shoqëritë pensionale, caktohet në bazë të analizës së nevojave të Agjencionit për kryerjen optimale të kompetencave të përcaktuara dhe me respektimin e parimit të minimizimit të shpenzimeve. Në këtë drejtim, është shënuar trendi i uljes së lartësisë së kompensimit prej 1,5% në vitet 2006 dhe 2007 në 1% në vitet 2008 dhe 2009, pastaj 0,8% nga viti 2010 deri në vitin 2022 dhe 0,7% në vitin 2023. Lartësia e kompensimit mujor prej 0,7% të kontributeve të përgjithshme, të paguara në muajin paraprak në çdo fond pensional me të cilin menaxhon shoqëria pensionale, planifikohet për vitin 2023.

*Propozim-Plani Financiar i Agjencionit për vitin 2023 është përcaktuar në bazë të:*

- Realizimit të Planit Financiar për vitin 2022;
- Kompensimeve të pritshme dhe të ardhurave të tjera në vitin 2023;
- Realizimit të aktiviteteve të filluara dhe aktiviteteve të reja sipas programit vjetor për punën e Agjencionit për vitin 2023, dhe
- Shpenzimeve të planifikuara për vitin 2023.

## II. PLANI FINANCIAR PËR VITIN 2023

Në bazë të supozimeve të theksuara paraprakisht, për vitin 2023 planifikohen këto të ardhura dhe shpenzime të Agjencionit.

## 1. TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA

Gjatë vitit 2023 planifikohet Agjencioni të realizojë të ardhura të përgjithshme në shumë prej **85.000.000 denarë**, struktura e tyre sipas burimeve të mjeteve është si në vijim:

1.1 Kompensimi nga kontributet nga shoqëritë pensionale	78.000.000 denarë
1.2 Kompensimet administrative	5.500.000 denarë
1.3 Të ardhurat nga kamatat	<u>1.500.000 denarë</u>
<b>TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME</b>	<b>85.000.000 denarë</b>

Shuma e planifikuar e të ardhurave nga kontributet nga shoqëritë pensionale prej **78.000.000 denarë** pritet të realizohet me arkëtimin e kompensimit mujor nga shoqëritë pensionale prej 0,7% të kontributeve të përgjithshme, të paguara në muajin paraprak në çdo fond pensional të cilin e menaxhon shoqëria pensionale. Gjatë planifikimit të të ardhurave të kompensimit mujor nga kontributet, Agjencioni i kishte parasysh projeksionet aktuale të Fondit të SPIM-së për vitin 2023 të marra në vitin 2015 dhe duke pasur parasysh se në vitin 2022 jemi njoftuar se Fondi i SPIM-së nuk i ka përditësuar projeksionet, Agjencioni bëri vlerësimin në bazë të të dhënave të kaluara dhe në bazë të informacionit për projeksionet buxhetore në klasin e shpenzimeve të tranzicionit të Fondit të SPIM-së.

Shuma prej **5.500.000 denarë** janë të ardhurat në bazë të kompensimeve administrative dhe kjo shumë është rritur lidhur me vitin paraprak për arsye të licencimit shtesë të shoqërisë së re pensionale në vitin 2022. Në vitin 2023 në sistemin pensional do të kemi katër shoqëri pensionale prej të cilave tri menaxhojnë me nga një fond të detyrueshëm pensional dhe një fond vullnetar pensional dhe një shoqëri menaxhon me një fond vullnetar pensional. Kjo nënkupton se Agjencioni në vitin 2023 do të pret vëllim të shtuar të kërkesave administrative nga nevojat e mbikëqyrjes dhe nevojat rregullatore të sistemit pensional.

Shuma prej **1.500.000 denarë** janë të ardhurat e planifikuara nga kamatat që Agjencioni pritet t'i arkëtojë nga depozitat e afatizuara nga fondi rezervë në bankat e veçanta, në pajtim me rritjen e pritshme të kamatave dhe Vendimin për ndarjen dhe investimin e tepërcës së të ardhurave të Agjencionit.



## **2. SHPENZIMET E PLANIFIKUARA**

Gjatë planifikimit të shpenzimeve për punën e Agjencionit për vitin 2023, u mor parasysh shpenzimi racional i mjeteve të nevojshme për kryerjen cilësore, efikase dhe të vazhdueshme të detyrave, obligimeve dhe kompetencave të Agjencionit që dalin nga Ligji për sigurimin e detyrueshëm pensional me finansim kapital.

Shpenzimet e përgjithshme për vitin 2023 planifikohen të jenë **84.630.000 denarë** dhe planifikohen të shfrytëzohen për nevojat si në vijim:

### **2.1 Materialet e shpenzuara**

Për prokurimin e materialeve të nevojshme për funksionimin e vazhdueshëm dhe të përditshëm të Agjencionit, në vitin 2023 planifikohet të shpenzohen 810.000 denarë, për prokurimin e:

- Karburantit;
- Materialeve të zyrës, dhe
- Inventarit të imët.

Shpenzimet e planifikuara për **Materialet e shpenzuara** në vitin 2023 janë më të larta për 33% lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022 për ndryshimin e shtuar të çmimeve të karburanteve duke u rritur në periudhën e kaluar dhe për të cilat pritet të vazhdojë fluktuacioni edhe në vitin 2023.

### **2.2 Energjia e shpenzuar dhe shërbimet komunale**

Për shpenzimet e energjisë elektrike dhe pagesën e shërbimeve komunale në vitin 2023 planifikohen shpenzime në shumë prej **2.400.000 denarë** për:

- Energjinë elektrike dhe
- Ujin, shpenzimet tjera komunale dhe ngrohjen qendrore.

Shpenzimet e planifikuara për energjinë elektrike janë 1.500.000 denarë dhe rritja u referohet ndryshimeve të caktuara të rritjes së çmimit të energjisë elektrike në tregun e lirë.

Shpenzimet e planifikuara për ujin, shpenzimet tjera komunale dhe ngrohjen qendrore janë 900.000 denarë.

Shpenzimet e planifikuara për energjinë e shpenzuar dhe shërbimet komunale në vitin 2023 janë më të larta për 71% lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

### 2.3 Mirëmbajtja investuese e mjeteve

Shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtjen investuese të mjeteve janë 30.000 denarë për:

- Instalimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të zjarrit.

Shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtjen investuese të mjeteve në vitin 2023 janë në të njëjtin nivel lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022 për shkak të nevojës nga kontrollimi i rregullt i sistemit për mbrojtjen nga zjarri të resurseve njerëzore dhe materiale të Agjencionit nga mbikëqyrja e licencuar dhe profesionale.

### 2.4 Shërbimet e tjera

Mjetet e vlerësuara për kategorinë **Shërbimet e tjera** të shpenzimeve në shumën e përgjithshme prej 15.580.000 denarë planifikohen të dedikohen për:

- Mirëmbajtjen e softuerit për shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional;
- Mirëmbajtjen e pajisjes IBM të harduerit;
- Mirëmbajtjen e softuerit për arkiv;
- Mirëmbajtjen e softuerit për kontabilitet;
- Shërbimet për lokacionin sekondar;
- Dërgesat postare;
- Mirëmbajtjen higjienike të lokaleve;
- Shërbimet telefonike të komunikimit;
- Shërbimet për botimin, kopjimin dhe konvertimin e letrave;
- Kompensimin për parking;
- Mirëmbajtjen dhe servisimin e automjeteve;
- Mirëmbajtjen e pajisjes teknike;
- Riparimet e objektit afarist;
- Aktivitetet informative për zhvillimin e finansimit kapital të sigurimit pensional;
- Servisin financiar informativ dhe
- Mirëmbajtjen e faqes së internetit.

Shpenzimet e planifikuara për **Shërbimet e tjera** i përmbajnë shpenzimet për shkak të realizimit të veprimtarisë, të tilla si mirëmbajtja e softuerit për shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional, mirëmbajtja e pajisjes IBM të harduerit, mirëmbajtja e softuerit për arkiv dhe për kontabilitet dhe orë pune për mirëmbajtjen e atyre softuerëve nga firma e jashtme për teknologjinë informatike. Lokacioni sekondar është i nevojshëm për mbrojtjen e të dhënave dhe aplikacioneve, si dhe mbrojtjen nga mosfunksionimi i pajisjes ose mospasjes së qasjes në lokacionin primar të cilësimeve të informacioneve. Pastaj, merret me qira zgjidhja e plotë e subjektit të jashtëm në largësi minimale prej 100 km në



tokë dhe 80 km largësi ajrore nga lokacioni primar. Mirëmbajtja e lokacionit sekondar dhe pajisjes për cilësimet e informacioneve është vegël e rëndësishme nga sistemi i menaxhimit me siguri të informacioneve për autorizim dhe përvokim.

Shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtjen e softuerit për shtyllën e dytë dhe të tretë janë 4.300.000 denarë për nevojën e punës së vazhdueshme dhe përditësimin e aplikacioneve lidhur me subjektet e sistemit pensional nga Fondi i SPIM-së, shoqëritë pensionale dhe bankat – kujdestarët e pronës, pastaj për mungesën e kuadrit të TI-së për mirëmbajtjen dhe për ndryshimin e çmimit të rritur të shërbimeve të TI-së.

Shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtjen e softuerit për arkiv janë 500.000 denarë. Agjencioni planifikon përmirësimin e softuerit për arkiv në pjesën e arkivimit dhe lëshimit të certifikatave elektrike për agjentët e shoqërive pensionale pas dhënies së provimit për agjent të finansimit kapital të sigurimit pensional.

Shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtjen e softuerit për kontabilitet janë 400.000 denarë. Ato janë dukshëm më pak lidhur me vitin paraprak për përmirësimin tashmë të bërë të softuerit në vitin 2022 për arsye të automatizimit të procesit dhe për ndryshimet rregullatore.

Shpenzimet e planifikuara për mirëmbajtjen e pajisjes IBM të harduerit janë 1.200.000 denarë. Shpenzimet planifikohen për mirëmbajtjen e saj të rregullt, servisin dhe zëvendësimin eventual të pajisjes jofunksionale.

Shpenzimet e planifikuara për aktivitetet informative i përfshijnë shpenzimet për shërbimet për promovimin, organizimin dhe nxitjen e zhvillimit të finansimit kapital të sigurimit pensional që janë 5.000.000 denarë. Obligimi ligjor i Agjencionit është të caktojë mjete që u referohen aktiviteteve informative për anëtarët e fondeve pensionale me qëllim të përforcohet ndërgjegjësimi i anëtarëve dhe opinionit për qëllimet dhe parimet e shoqërive pensionale dhe fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale, për përfitimet nga anëtarësimi në fondin e detyrueshëm dhe/ose vullnetar pensional, duke i përfshirë edhe qëllimet, parimet dhe përfitimet nga pjesëmarrja në skemën pensionale profesionale, për të drejtat e anëtarëve të fondeve të detyrueshme dhe vullnetare pensionale dhe për çështjet e tjera lidhur me finansimin kapital të sigurimit pensional. Një pjesë e shpenzimeve të Agjencionit në vitin 2023 planifikohet për aktivitetet për organizimin e evenimentit “15 Shtatori – Dita e Ndërgjegjësimit Pensional” i cili mbahet çdo vit në periudhën afër 15 shtatorit me qëllim të ndërgjegjësimit të opinionit për finansimin kapital të sigurimit pensional.

Në vitin 2022, për fat të keq, nuk u zbatuan aktivitetet informative për promovimin e finansimit kapital të sigurimit pensional nga njëra anë për arsye të rekomandimit të Qeverisë së RMV-së për kufizimin e shpenzimeve për këtë qëllim dhe nga ana tjetër shumës së zvogëluar për promovim nuk i përfshiu qëllimet e planifikuara të Agjencionit. Për këto arsye, shpenzimet në këtë bazë ishin minimale në vitin 2022.

Shpenzimet e planifikuara për Shërbimet e tjera në vitin 2023 janë më pak për 1% lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.



## 2.5 Shërbimet e transportit

Për prokurimin e **Shërbimeve të transportit** për nevojat e Agjencionit në vitin 2023 janë planifikuar 60.000 denarë.

Shpenzimet e planifikuara për **Shërbimet e transportit** në vitin 2023 janë në të njëjtin nivel lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## 2.6 Shpenzimet për reklama dhe reprezentacion

Për reklama dhe reprezentacion në vitin 2023 planifikohen shpenzimet në shumë prej **800.000 denarë** të dedikuara për:

- Reprezentacion dhe
- Shërbimet për botimin e materialit reklamues.

Shërbimet për botimin e materialit reklamues u dedikohen evenimenteve të cilat Agjencioni i zbaton me mbikëqyrësit e tjerë financiarë në shtet me qëllim të ndërgjegjësimit mbi edukimin financiar dhe gjithëpërfshirjen financiare të opinionit. Njëpërmjet trupit koordinues të mbikëqyrësve financiarë zbatohen evenimentet “Dita e Ndërgjegjësimit Pensional” dhe “Java globale e të hollave”.

Shpenzimet e planifikuara për reprezentacion i referohen organizimit të evenimenteve zyrtare dhe prokurimeve për nevojat e resurseve njerëzore të Agjencionit.

Shpenzimet e planifikuara për reklama dhe reprezentacion në vitin 2023 janë më të larta për 14% lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## 2.7 Qiratë

Për vitin 2023 planifikohen shpenzimet në shumë prej **1.360.000 denarë** për:

- Marrjen me qira të sallave dhe amfiteatrove;
- Marrjen me qira të linjës së internetit;
- Marrjen me qira të pajisjes tjetër, dhe
- Marrjen me qira të automjeteve.

Mjetet e planifikuara për **Qiratë** janë për marrjen me qira të sallave dhe amfiteatrove për nevojat e Agjencionit për zbatimin e trajnimeve, marrjen me qira të linjës së internetit dhe për marrjen me qira të pajisjes tjetër, përkatësisht marrjen me qira të printerëve dhe skenerëve për nevojat e Agjencionit dhe për marrjen me qira të automjeteve.

Shpenzimet e planifikuara për marrjen me qira të automjeteve janë 1.100.000 denarë. Agjencioni vazhdimisht njëpërmjet lizingut operativ çdo tre vjet siguron dy automjete zyrtare. Automjetet janë në klasin e automjeteve me madhësi të mesme dhe

nivel të mesëm të pajisjes, që përdoren për nevojat zyrtare të Agjencionit nga aspekti i mbikëqyrjes dhe rregullativës.

Shpenzimet e planifikuara për Qira për vitin 2023 janë në të njëjtin nivel lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## 2.8 Shërbimet tjera materiale

Në zërin Shërbimet tjera materiale janë shpenzimet e planifikuara në shumë prej **380.000 denarë** për:

- Blerjen e revistave, literaturës profesionale, gazetave dhe ngjashëm;
- Pagesën e kompensimit për këmbimin e të dhënave të bursës dhe arkës – shpenzimet materiale;
- Shpenzimet për blerjen e mjeteve të higjienës;
- Sigurimin teknik dhe të patrullimit të lokaleve të Agjencionit;
- Shpenzimet për regjistrimin dhe kontrollimin teknik të automjeteve dhe
- Shërbimet për deratizimin dhe dezinfektimin.

Shpenzimet e planifikuara për **Shërbimet tjera materiale** për vitin 2023 janë në të njëjtin nivel lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## 2.9 Provizioni për qarkullimin pagesor

Mjetet e kësaj kategorie të shpenzimeve janë **60.000 denarë** dhe i referohen provizionit për qarkullimin pagesor dhe provizionit bankar për blerjen e devizave.

Shpenzimet e planifikuara për **Kompenzimin për qarkullimin pagesor** për vitin 2023 janë në të njëjtin nivel lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## 2.10 Premitë e sigurimit

Për vitin 2023 planifikohen shpenzimet në shumë prej **140.000 denarë** për:

- Sigurimin e të punësuarve dhe sigurimin e udhëtarëve në Agjension;
- Sigurimin e udhëtarëve për udhëtimet zyrtare të të punësuarve jashtë vendit;
- Sigurimin e objektit të punës nga fatkeqësitë, dhe
- Sigurimin e automjeteve zyrtare.

Shpenzimet e planifikuara për **Premitë e sigurimit** për vitin 2023 janë më të larta për 27% lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## 2.11 Shpenzimet e rrugës dhe shpenzimet ditore

Shuma e planifikuar e shpenzimeve për udhëtimet zyrtare brenda dhe jashtë vendit është vlerësuar me **1.600.000 denarë**. Këto shpenzimet përfshijnë: shpenzimet e akomodimit, ushqimit dhe transportit (mëditjet për udhëtimin zyrtar, shpenzimet e bujtjeve dhe shpenzimet e tjera lidhur me udhëtimin). Mëditjet për udhëtimet zyrtare jashtë vendit rregullohen me Aktvendim për shumat më të larta të mëditjeve për udhëtimet zyrtare dhe shpërnguljet jashtë vendit, shpenzimet që u njihen organeve të administratës shtetërore në shpenzimet rrjedhëse (Gazeta Zyrtare e RM-së, nr. 19/14 në zbatim nga 01.01.2015).

Shpenzimet e planifikuara për **Shpenzimet e rrugës dhe shpenzimet ditore** për vitin 2023 janë në të njëjtin nivel lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## 2.12 Taksat e anëtarësisë

Planifikohet gjatë vitit 2023 Agjencioni të paguajë **440.000 denarë** për:

- Anëtarësinë vjetore në IOPS – Organizatë Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve Pensionalë;
- Anëtarësinë vjetore për Organizatën e Punëdhënësve e Maqedonisë;
- Anëtarësinë vjetore për INFE – Rrjeti Ndërkombëtar për Arsimin Financiar dhe OECD – Organizatë për Bashkëpunimin dhe Zhvillimin Ekonomik dhe
- Anëtarësinë vjetore për Shoqatën e Revizorëve të Brendshëm.

Shpenzimet e planifikuara për **Taksat e anëtarësisë** për vitin 2023 janë në të njëjtin nivel lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## 2.13 Shërbimet intelektuale dhe shërbimet e tjera

Shpenzimet e planifikuara për **Shërbimet intelektuale dhe shërbimet e tjera** për vitin 2023 janë në shumë prej 4.060.000 denarë. Planifikohet që këto të përdoren për pagesën e:

- Kompensimit për anëtarët e jashtëm të Këshillit të Ekspertëve;
- Shërbimeve tjera – vlerësues, noter;
- Përkthimit të teksteve;
- Lektorimit të teksteve;
- Revizionit të jashtëm;
- Trajnimeve për përsosjen profesionale, seminareve dhe konferencave;
- Kontrollimit të jashtëm të sistemit të TI-së;
- Ricertifikimit ISMS-ISO 27001, dhe



- Shërbimeve kontraktuese.

Shpenzimet e planifikuara për **Shërbimet intelektuale dhe shërbimet e tjera** për vitin 2023 janë më të larta lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022. Agjencioni planifikon mjete shtesë në këto zëra: trajnime për përsosjen profesionale të të punësuarve, pastaj për arsye të Ligjit për gjuhët është planifikuar vëllimi i shtuar i materialeve të përkthyer, në zërin kontrollimi i jashtëm i sistemit të TI-së, si dhe zëri për shërbimet kontraktuese për arsye të nxitjes së zhvillimit të finansimit kapital të sigurimit pensional.

#### 2.14 Shpenzimet e tjera

Në zërin **Shpenzimet e tjera** për vitin 2023 janë planifikuar shpenzimet në shumë prej **470.000 denarë** që përfshijnë shpenzimet për shpalljen e konkurseve dhe botimin në gazetatat dhe Gazetën Zyrtare, konkurseve për prokurimet publike, tatimet tjera publike që u referohen institucioneve publike / shtetërore dhe shpenzimet tjera për çështjet e paparashikueshme.

Shpenzimet e planifikuara për **Shpenzimet e tjera** për vitin 2023 janë më të larta për 17% lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022 për nevojën për rritjen e nënzërit Shpallja e konkurseve në të cilën evidentohen shpenzimet për shpallje për nevojat e prokurimeve publike të Agjencionit, si dhe për botimin në Gazetën Zyrtare të RMV-së për nevojat e rregullativës në finansimin kapital të sigurimit pensional.

#### 2.15 Mjetet për objektet ndërtimore

Në zërin **Mjetet për objektet ndërtimore** parashihen shpenzimet për zgjidhjet arkitektonike dhe elaborat, rikonstrukcionin dhe për vitin 2023 propozojmë zë të ri për investim në Panelet Solare – Fotovoltaikët. Vlera e përgjithshme e përcaktuar e kësaj kategorie të shpenzimeve është **3.150.000 denarë**.

Shpenzimet e planifikuara për **Mjetet për objektet ndërtimore** në vitin 2023 janë dukshëm më të larta lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022 për shkak të nevojës për rikonstrukcionin e çatisë së objektit ekzistues dhe ndërmarrjen e masave për investime në burime të rinovueshme të energjisë në pajtim me rekomandimin e Qeverisë së RMV-së. Për shkak të varësisë nga energjia elektrike e Agjencionit për nevojën e vazhdueshme të teknologjisë informatike dhe lidhshmërisë, Agjencioni planifikon të hartojë elaborat për vlerësimin dhe analizimin për mjetet e nevojshme dhe më pas investimin për vendosjen e paneleve solare – fotovoltaikëve për nevojat e Agjencionit.

## 2.16 Mjetet për pajisje

Në zërin **Mjetet për pajisje** për vitin 2023 janë planifikuar shpenzimet në shumë prej 4.000.000 denarë.

Gjatë vitit 2023 Agjencioni do të ketë nevojë për pajisje me server të ri dhe hapësirë në disk për integrimin me sistemin e interoperabilitetit nga MSHIA. Serveri nevojitet për bekapin e të dhënave që shkëmbehen me entitetet e interesuara. Përveç kësaj, nevojitet edhe prokurimi i pajisjes kompjuterike shtesë, printerëve, ups-ve dhe pajisjes tjetër teknike të informacioneve për nevojat e të punësuarve në Agjencion.

Shpenzimet e planifikuara për **Mjetet për pajisje** në vitin 2023 janë në të njëjtin nivel lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## 2.17 Mjetet tjera kapitale

Në zërin **Mjetet tjera kapitale** për vitin 2023 janë planifikuar shpenzimet në shumë prej 8.840.000 denarë për:

- Mobilitet e zyrës;
- Licencat softuerike;
- Mbrojtjen kundër virusit Checkpoint 4400;
- Softuerin e ri kompjuterik, dhe
- Softuerin për organizimin dhe dhënien e provimeve për agjentët e Sekretariatit të Përgjithshëm.

Shpenzimet e planifikuara për licencat softuerike janë 1.500.000 denarë. Kjo i referohet nevojës për prokurimin e mikrosft 365 licencave vjetore për një numër të madh të të punësuarve. Prokurimi i planifikuar i licencave sq1 për integrimin me sistemin e interoperabilitetit të MSHIA-së dhe prokurimi i licencave për bekap.

Shpenzimet për mbrojtjen kundër virusit dhe softuerit kompjuterik – softuerit të ri janë me rëndësi për arsye që Agjencioni si trup mbikëqyrës është pjesa qendrore e sistemit të lidhur informatik nëpërmjet të cilit kryhen proceset e punës së sistemit pensional të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Mjetet për softuerin kompjuterik – softuerin e ri do të dedikohen për shtimin e funksionaliteteve të reja dhe ndryshimeve në aplikacionet softuerike që i referohen vendosjes së sistemit për menaxhimin me sigurinë e informacioneve për autorizim dhe përvokim të shfrytëzuesve. Plotësimet dhe ndryshimet e planifikuara janë për përmbushjen e obligimeve ligjore dhe veprimin sipas rekomandimeve të konsultantëve të revizioneve të jashtme. Funksionalitetet për autorizim dhe përvokim të shfrytëzuesve janë ruajtja e përhershme e të gjitha aksioneve të ndërmarra nga shfrytëzuesit e sistemeve përkatëse, ruajtja e përhershme e të dhënave në të cilat shfrytëzuesit kanë pasur qasje, përkatësisht logimi me qëllim të mundësimin të përvokimit të qasjes në to nga shfrytëzuesi në rast të situatave të ardhshme kontestuese



(për shembull dalja e të dhënave). Prokurimet do të realizohen në pajtim me Ligjin për prokurime publike. Ato konsiderohen aktivitete të investimeve duke pasur parasysh afatin e gjatë dhe madhësinë e vlerës së mjeteve.

Shpenzimet për shfrytëzimin e softuerit për organizimin dhe dhënien e provimeve për marrjen e cilësisë së agjentit, në pajtim me të cilën pagesa bëhet nga mjetet personale të Agjencionit, si kompensim i paraparë për mirëmbajtjen dhe mbështetjen e zgjidhjes sistematike.

Shpenzimet e planifikuara për **Mjetet tjera kapitale** në vitin 2023 janë më të ulëta për 10% lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## **2.18 Rrogat dhe kompensimet e llogaritura**

Në zërin **Rrogat dhe kompensimet e llogaritura** janë planifikuar shpenzimet në shumë prej **40.000.000 denarë** për bruto-rrogat në pajtim me pozicionet e plotësuara në Rregulloren për sistematizimin e vendeve të punës në Agjencion, kompensimet për të punësuarit dhe për shpenzimet e tjera të parapara në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive. Në vitin 2023 përveç bruto-rrogave për të punësuarit dhe anëtarët e Këshillit të Ekspertëve të Agjencionit, gjithashtu janë planifikuar mjete për rritjen e mundshme të rrogave në pajtim me rekomandimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Shpenzimet e planifikuara për **Rrogat dhe kompensimet e llogaritura** në vitin 2023 janë më të larta për 14% lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022.

## **2.19 Tatimet dhe kontributet që nuk varen nga rezultati**

Në zërin **Tatimet dhe kontributet që nuk varen nga rezultati** për vitin 2023 janë planifikuar shpenzimet në shumë prej **450.000 denarë** që u referohen shpenzimeve për tatimin personal në bazë të pagesave të kompensimeve për anëtarët e jashtëm të Këshillit të Ekspertëve, etj.

Shpenzimet e planifikuara për **Tatimet dhe kontributet që nuk varen nga rezultati** në vitin 2023 janë dukshëm më të larta lidhur me shpenzimet e planifikuara sipas bazës së njëjtë për vitin 2022 në pajtim me projeksionet për kompensimet dhe shpenzimet e tjera për të cilat paguhet tatimi personal mbi të ardhura.

**Në pajtim me kategoritë e theksuara në detaje të Planit Financiar planifikohet shuma prej 370.000 denarë si dallim ndërmjet të ardhurave të përgjithshme dhe shpenzimeve të përgjithshme të Agjencionit në vitin 2023.**

Në pajtim me nenin 56-a të Ligjit, nëse gjatë vitit paraprak të punës, Agjencioni realizon tepricë të ardhurash mbi shpenzimet e realizuara, teprica e realizuar e mjeteve ndahet në fondin rezervë të Agjencionit në shumën e caktuar me Planin Financiar të Agjencionit.



Bashkëngjitja 1: Agjencioni për Mbikëqyrjen e Finansimit Pensional – Pasqyra analitike e të ardhurave dhe shpenzimeve

Nr. r.	PËRSHKRIMI	I MIRATUAR 2022	Realizuar deri më 30.08.2022	VITI 2022		INDEKSI	PLANI 2023
				Vlerësimi prej 30.08. deri më 31.12.2022	Gjithsej viti 2022		
1	2	3	4	5	6=4+5	7=6/3	8
<b>A</b>	<b>TË ARDHURAT E PLANIFIKUARA</b>	<b>75.600.000</b>	<b>50.120.996</b>	<b>35.381.936</b>	<b>85.502.932</b>	<b>113</b>	<b>85.000.000</b>
1.1	Kompensimi mujor nga kontributet	71.000.000	47.422.064	33.577.936	81.000.000	114	78.000.000
1.2	Kompensimet administrative	3.800.000	2.685.000	1.115.000	3.800.000	100	5.500.000
1.3	Të ardhurat nga kamatat	800.000	13.932	689.000	702.932	88	1.500.000
<b>B.</b>	<b>SHPENZIMET E PLANIFIKUARA</b>	<b>75.250.000</b>	<b>37.489.581</b>	<b>26.824.260</b>	<b>64.313.841</b>	<b>85</b>	<b>84.630.000</b>
<b>1.</b>	<b>MATERIALET E SHPENZUARA</b>	<b>610.000</b>	<b>242.573</b>	<b>358.819</b>	<b>601.392</b>	<b>99</b>	<b>810.000</b>
1.1	Karburanti	400.000	228.312	163.080	391.392	98	600.000
1.2	Materialet e zyrës	150.000	1.473	148.527	150.000	100	150.000
1.3	Inventari i imët	60.000	12.788	47.212	60.000	100	60.000
<b>2</b>	<b>ENERGJIA E SHPENZUAR, SHËRBIMET KOMUNALE</b>	<b>1.400.000</b>	<b>764.613</b>	<b>546.152</b>	<b>1.310.765</b>	<b>94</b>	<b>2.400.000</b>
2.1	Energjia elektrike	800.000	477.048	340.749	817.797	102	1.500.000
2.2	Uji, shpenzimet e tjera komunale dhe ngrohja qendrore	600.000	287.565	205.404	492.969	82	900.000

<b>3.</b>	<b>MIRËMBAJTJA INVESTUESE E MJETEVE</b>	<b>30.000</b>	<b>0</b>	<b>30.000</b>	<b>30.000</b>	<b>100</b>	<b>30.000</b>
3.1	Instalimi dhe mirëmbajtja e sistemit të zjarrit	30.000	0	30.000	30.000	100	30.000
<b>4.</b>	<b>SHËRBIMET E TJERA</b>	<b>15.800.000</b>	<b>5.205.117</b>	<b>5.375.647</b>	<b>10.580.764</b>	<b>67</b>	<b>15.580.000</b>
4.1	Mirëmbajtja e softuerit për shtyllën e dytë dhe të tretë të sistemit pensional	4.300.000	1.738.140	2.561.860	4.300.000	100	4.300.000
4.2	Mirëmbajtja e pajisjes IBM të harduerit	1.200.000	699.622	500.378	1.200.000	100	1.200.000
4.3	Mirëmbajtja e softuerit për arkiv	600.000	170.982	429.018	600.000	100	500.000
4.4	Mirëmbajtja e softuerit për kontabilitet	720.000	472.308	247.692	720.000	100	400.000
4.5	Shërbimet për lokacionin sekondar	1.200.000	599.994	600.006	1.200.000	100	1.200.000
4.6	Dërgesat postare	500.000	116.216	83.011	199.227	40	400.000
4.7	Mirëmbajtja higjienike e lokaleve	240.000	70.800	50.571	121.371	51	300.000
4.8	Shërbimet telefonike të komunikimit	600.000	240.105	171.504	411.609	69	600.000
4.9	Shërbimet për botimin, kopjimin dhe konvertimin e letrave	300.000	64.887	46.348	111.235	37	300.000
4.10	Kompensimi për parking	60.000	11.200	48.800	60.000	100	80.000
4.11	Mirëmbajtja dhe servisimi i automjeteve	250.000	21.901	228.099	250.000	100	250.000
4.12	Mirëmbajtja e pajisjes teknike	60.000	23.550	16.821	40.371	67	60.000
4.13	Riparimet e objektit të punës	150.000	18.257	131.743	150.000	100	220.000
4.14	Aktivitetet informative për zhvillimin e finansimit kapital të sigurimit pensional	5.000.000	596.950	0	596.950	12	5.000.000

4.15	Servisi financiar informativ	620.000	360.205	259.795	620.000	100	700.000
4.16	Mirëmbajtja e faqes së internetit	0	0	0	0	0	70.000
<b>5.</b>	<b>SHËRBIMET E TRANSPORTIT</b>	<b>60.000</b>	<b>9.207</b>	<b>50.793</b>	<b>60.000</b>	<b>100</b>	<b>60.000</b>
5.1	Shërbimet e transportit	60.000	9.207	50.793	60.000	100	60.000
<b>6.</b>	<b>SHPENZIMET PËR REKLAMA DHE REPREZENTACION</b>	<b>700.000</b>	<b>319.367</b>	<b>380.633</b>	<b>700.000</b>	<b>100</b>	<b>800.000</b>
6.1	Reprezentacioni	400.000	319.367	80.633	400.000	100	500.000
6.2	Shërbimet për bctimin e materialit reklamues	300.000	0	300.000	300.000	100	300.000
<b>7.</b>	<b>QIRATË</b>	<b>1.360.000</b>	<b>780.502</b>	<b>544.388</b>	<b>1.324.890</b>	<b>97</b>	<b>1.360.000</b>
7.1	Marrja me qira e sallave dhe amfiteatrove	30.000	0	30.000	30.000	100	30.000
7.2	Marrja me qira e linjës së internetit	150.000	68.667	49.048	117.715	78	150.000
7.3	Marrja me qira e pajisjes tjetër	80.000	45.019	32.256	77.175	96	80.000
7.4	Marrja me qira e automjeteve	1.100.000	666.816	433.184	1.100.000	100	1.100.000
<b>8.</b>	<b>SHËRBIMET TJERA MATERIALE</b>	<b>380.000</b>	<b>125.879</b>	<b>108.747</b>	<b>234.626</b>	<b>62</b>	<b>380.000</b>
8.1	Blerja e revistave, literaturës profesionale, gazetave dhe ngjashëm	50.000	9.975	7.125	17.100	34	50.000
8.2	Pagesa e kompensimit për këmbimin e të dhënave të bursës dhe arkës - shpenzimet materiale	200.000	69.640	49.743	119.383	60	200.000
8.3	Shpenzimet për blerjen e mjeteve të higjienës	60.000	18.400	13.143	31.383	53	60.000
8.4	Sigurimi teknik dhe i patrullimit të lokaleve të Agjencionit	35.000	15.264	19.736	35.000	100	35.000
8.5	Shpenzimet për regjistrimin dhe kontrollimin teknik të	10.000	0	10.000	10.000	100	10.000





13.1	Kompensimi për anëtarët e jashtëm të Këshillit të Ekspertëve	800.000	414.714	296.224	710.938	89	900.000
13.2	Shërbimet tjera - vlerësues, noter	20.000	0	20.000	20.000	100	20.000
13.3	Përkthimi i teksteve	600.000	383.606	216.394	600.000	100	1.000.000
13.4	Lektorimi i teksteve	10.000	0	10.000	10.000	100	10.000
13.5	Revizioni i jashtëm	150.000	149.409	0	149.409	100	180.000
13.6	Shërbimet e konsultantëve	200.000	0	0	0	0	0
13.7	Trajnimet për përsosjen profesionale, seminareve dhe konferencave	500.000	231.612	165.437	397.049	79	900.000
13.8	Kontrollimi shëndetësor i të punësuarve	250.000	108.800	77.714	186.514	75	0
13.9	Ricertifikimi ISMS-ISO 27001	130.000	0	130.000	130.000	100	50.000
13.10	Kontrollimi i jashtëm i sistemit të TI-së	0	0	0	0	0	400.000
13.11	Shërbimet kontraktuese	240.000	0	240.000	240.000	100	600.000
<b>14.</b>	<b>SHPENZIMET E TJERA</b>	<b>400.000</b>	<b>130.611</b>	<b>93.294</b>	<b>223.905</b>	<b>56</b>	<b>470.000</b>
14.1	Shpallja e konkurseve	80.000	67.853	48.466	116.319	145	150.000
14.2	Tatimet tjera publike	20.000	50	36	86	0	20.000
14.3	Shpenzimet tjera për çështjet e paparashikueshme	300.000	62.708	44.791	107.499	36	300.000
<b>15.</b>	<b>MJETET PËR OBJEKTET NDËRTIMORE</b>	<b>330.000</b>	<b>0</b>	<b>330.000</b>	<b>330.000</b>	<b>100</b>	<b>3.150.000</b>
15.1.	Zgjidhjet arkitektonike dhe elaborati	30.000	0	30.000	30.000	100	150.000
15.2	Rikonstruksioni	300.000	0	300.000	300.000	100	500.000

15.3	Panellet Solare – Fotovoltaiikët	0	0	0	0	0	0	0	0	2.500.000
16.	<b>MJETET PËR PAJISJE</b>	<b>4.000.000</b>	<b>3.999.592</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>3.999.592</b>	<b>0</b>	<b>3.999.592</b>	<b>100</b>	<b>4.000.000</b>
16.1	Pajisja kompjuterike	4.000.000	3.999.592	0	0	3.999.592	0	3.999.592	100	4.000.000
17.	<b>MJETET TJERA KOMUNALE</b>	<b>9.790.000</b>	<b>5.870.820</b>	<b>2.771.451</b>	<b>0</b>	<b>8.642.271</b>	<b>0</b>	<b>8.642.271</b>	<b>88</b>	<b>8.840.000</b>
17.1	Mobiliet e zyrës	150.000	57.549	0	0	57.549	0	57.549	38	200.000
17.2	Licencat softuerike	2.500.000	2.493.240	0	0	2.493.240	0	2.493.240	100	1.500.000
17.3	Mbrojtja kundër virusit	400.000	0	400.000	0	400.000	0	400.000	100	400.000
17.4	Softueri kompjuterik – softueri i ri	6.500.000	3.217.506	2.298.219	0	5.515.725	0	5.515.725	85	6.500.000
17.5	Pjesëmarrja në prokurimin e softuerit për organizimin dhe dhënien e provimeve për agjentë	240.000	102.525	73.232	0	175.757	0	175.757	73	240.000
18.	<b>RROGAT DHE KOMPENSIMET E LLOGARITURA</b>	<b>35.080.000</b>	<b>17.908.890</b>	<b>14.707.445</b>	<b>0</b>	<b>32.616.335</b>	<b>0</b>	<b>32.616.335</b>	<b>93</b>	<b>40.000.000</b>
18.1	Rrogat e llogaritura	33.600.000	16.765.719	14.370.616	0	31.136.335	0	31.136.335	93	37.000.000
18.2	Kompensimet dhe ndihmat tjera në pajtim me ligjin dhe marrëveshjen kolektive	1.480.000	1.143.171	336.829	0	1.480.000	0	1.480.000	100	3.000.000
19.	<b>TATIMET DHE KONTRIBUTET QË NUK VAREN NGA REZULTATI</b>	<b>200.000</b>	<b>168.678</b>	<b>84.339</b>	<b>0</b>	<b>253.017</b>	<b>0</b>	<b>253.017</b>	<b>127</b>	<b>450.000</b>
19.1	Tatimi personal për kompensimet për anëtarët e jashtëm të Këshillit të Ekspertëve, etj.	200.000	168.678	84.339	0	253.017	0	253.017	127	450.000



## Bashkëngjitja 2. Rezultati i planifikuar financiar për vitin 2023

Tabela 2

REZULTATI FINANCIAR	
TË ARDHURAT E PËRGJITHSHME TË PLANIFIKUARA RRJEDHËSE	85.000.000
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME TË PLANIFIKUARA RRJEDHËSE	84.630.000
REZULTATI FINANCIAR NGA VITI RRJEDHËS PËRPARA TATIMIMIT (1-2) QË BARTET NË FONDIN REZERVË	370.000

\* Ndryshim dhe plotësim të Planit Financiar bën Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut. Gjatë vitit Këshilli i Ekspertëve i Agjencionit mund të bëjë ridedikimin e Planit Financiar Vjetor vetëm nëse bëhet fjalë për shpenzimet të cilat nuk mund të planifikohen me kohë. Për kryerjen e ridedikimit nevojitet të dorëzohet arsyetimi në Këshillin e Ekspertëve të Agjencionit. Ridedikimi mund të bëhet në kuadër të zërit të njëjtë, por jo më tepër se shuma e përgjithshme e shpenzimeve të planifikuara në Planin Financiar të Agjencionit të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.